

VENDIM
Nr.824, datë 23.11.2011

PËR LEJIMIN E REALIZIMIT TË PROCEDURAVE DHE SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT E TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS, INSTITUCIONET NË VARËSI TË SAJ DHE NJËSITË E QEVERISJES VENDORE, SI AUTORITETE KONTRAKTORE, PËR PUNIMET E PROJEKTEVE TË REJA NË ARSIM

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të institucioneve në varësi të saj dhe të njësive të qeverisjes vendore, si autoritete kontraktore, që, për punimet e projekteve të reja në arsim, të realizojnë, brenda datës 10 dhjetor 2011, procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe ndërtime, me fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit, për vitin 2011, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati të përfshihen lidhja e kontratave përkatëse dhe botimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, institucionet në varësi të saj, Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe njësitë përkatëse të qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha